



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 21/ 06 / 2023

VENDIM

Nr.19, date 21 /06/2023

PËR

**RAPORTIN VJETOR PËR VITIN 2022 TË SHFRYTËZIMIT, OPERIMIT,
MIRËMBAJTJES, MONITORIMIT DHE SIGURISË PËR DIGËN E HEC MURDHAR**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 21.06.2023 mori në shqyrtim Raportin vjetor për vitin 2022 në lidhje me shfrytëzimin, operimin, monitorimin dhe sigurinë e diges së HEC Murdhar që administrohet nga HYDROENERGY shpk.

Nga shqyrtimi i Raportit vërehet se për këto dige nuk është hartuar dhe dorëzuar në KKDM plani i **gadishmërisë në rastet e emergjencave civile**, nuk janë paraqitur të dhëna në lidhje me monitorimin e integruar të tyre në vijueshmëri, **nuk ka matje të volumeve aktuale të ujit** në rezervuarin e krijuar nga kjo dige, nuk ka asnjë sistem alarmi të instaluar sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, nuk është dorëzuar asnjë vlerësim i aseteve diges dhe elementeve të saj.

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

- 1- Ti kërkohet kompanisë HYDROENERGY shpk si shfrytëzuese e diges së HEC Murdhar që administrohen prej saj:
 - Marrja e masave të duhura për monitorimin e digës përmes instalimit të instrumentave të sistemeve të monitorimit të kërkuara në nenet 32 dhe 33 të VKM përkatëse të dhëna me sipër. Në kuadër të këtyre masave duhet të kërket parashikimi i instalimit të sistemeve të monitorimit të diges në kohe reale dhe online si dhe krijimi i bazës së të dhënave të monitorimit të diges dhe rezervuarit të krijuar prej saj;
 - Kryerja e matjeve të volumeve aktuale të ujit në rezervuar, vlerësimin e sedimenteve të grumbulluara në të dhe të hartoj kurbat e reja të volumeve dhe të sipërfaqeve të ujit për rezervuarin deri në nivelin maksimal të ujit të parashikuar në projekt sipas kërkesave të nenit 30 të VKM së mesiperme;
 - Instalimi i sistemit të alarmit në rast të prishjes së diges dhe në rast të prurjeve maksimale të mundshme
 - Përgatitja e planit të gadishmërisë në rastet e emergjencave civile për shkak të prishjes së mundshme të diges apo prurjeve maksimale që mund të vijnë në rezervuar. Ky plan duhet të jetë i shoqëruar me hartat e përmbajtjeve sipas kërkesave të nenit 35 të VKM së mesiperme dhe të marrë në konsideratë matjet batimetrike për volumin aktual të ujit në rezervuar.
 - Hartimi i Rregullores së shfrytëzimit, monitorimit dhe sigurisë së diges sipas kërkesave të nenit 29 të VKM së mesiperme,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Përgatitja dhe dorëzimi pranë KKDM të një informacion në lidhje me vlerësimin e aseteve të digës dhe elementeve kryesore të saj sipas udhëzimeve të KKDM

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

